

**MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR
GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2024**

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2024

1.1. Operacione të tregut të hapur dhe faktorët që kanë ndikuar mungesën e likuiditetit në sistemin bankar

Tabelë 1: Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në miliardë lekë¹.)
Burimi: Banka e Shqipërisë.

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO >1javë <3muaj	REPO Njëditore	Totali i likuiditetit të injektuar
4-korrik-24		38.55			53.87
11-korrik-24		41.14			56.46
18-korrik-24		45.74			61.06
24-korrik-24			6.31		64.67
25-korrik-24		39.83			58.76
01-gusht-24		38.62			57.55
08-gusht-24		32.18			51.11
15-gusht-24		37.02			55.95
22-gusht-24		47.12			66.05
26-gusht-24			9.38		66.04
29-gusht-24		47.73			66.65
06-shtator-24		32.44			51.36
12-shtator-24		37.23			56.15
19-shtator-24		48.12			67.04
24-shtator-24			3.57		69.66
26-shtator-24		50.02			71.56

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë konsistuan në operacionet e tregut të hapur për injektim likuiditeti.

Injektimi mesatar ditor nëpërmjet operacioneve injektuese të likuiditetit me maturim 1-13 javë është rritur në mesatarisht **59.49 miliardë lekë** nga 44.55 miliardë lekë që rezultonte në tremujorin e mëparshëm dhe 22.70 miliardë në tremujorin e parë të vitit.

¹ Shifrat janë në vlerë likuiditeti.


Akumulimi i likuiditetit në llogarinë e MF ka qenë sërish faktori kryesor i rritjes së mungesës me një efekt kumulativ për rreth 25.20 miliardë lekë, pasuar nga rritja e parasë në qarkullim për 6.10 miliardë lekë si rrjedhojë e daljeve të larta në muajin korrik prej 8.24 miliardë lekë.

Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore kanë ndikuar në rritjen e likuiditetit të sistemit bankar me 28.30 miliardë lekë².

Gjatë periudhës, sistemi bankar ka përdorur instrumentin e depozitës për mesatarisht 1.3 miliardë lekë.

Mungesa e likuiditetit ka shënuar rritje gjatë gjithë periudhës dhe në reflektim të saj, Banka e Shqipërisë ka rritur injektimet me maturim tremujor deri në 21.30 miliardë lekë kundrejt 15.30 miliardë lekë në fillim të periudhës.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2016-2022 (me vlerë nominale)
Burimi: Banka e Shqipërisë.



² Llogaritur sipas datës së lëvizjes së fondeve.

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024

Ndryshe nga vitet e mëparshme, kur pesha e injektimeve të gjata ka rezultuar afër nivelit 50%, gjatë vitit 2024, në rastet e rritjes së mungesës mbi 50 miliardë lekë, pesha e injektimeve tremujore është synuar maksimalisht rreth nivelit 30%. Kjo ka synuar adresimin e skenarit të rritjes së shpenzimeve nga MF si dhe ndërhyrjeve në tregun valutor me efekt në rritjen e likuiditetit të vet bankave.



1.2 Përdorimi i operacioneve lehtësuese të përhershme.

Me rritjen e mungesës së likuiditetit, përdorimi i instrumentit të depozitës ka rënë më tej në 1.30 miliardë lekë nga mesatarisht 3.75 miliardë lekë në tremujorin e mëparshëm dhe 18.90 miliardë lekë në tremujorin e parë të këtij viti. Një vit më parë, në kushtet kur mungesa ka rezultuar në nivele të larta rekord, përdorimi i depozitës ka qenë vetëm 0.50 miliardë lekë.

Instrumenti i kredisë është përdorur në 3 raste kundrejt 12 rasteve në tremujorin e kaluar.


1.3 Operacionet strukturore për menaxhimin e likuiditetit të sistemit bankar dhe portofolin e

Bankës së Shqipërisë

Gjatë 3-mujorit tretë të vitit 2024, Banka e Shqipërisë nuk ka kryer operacione të blerjes apo shitjes së titujve, por ka ulur portofolin me 3.60 miliardë lekë pas maturimeve të bonove të thesarit nga MF. Në total, deri në fund të tremujorit të tretë portofoli ka rënë me 2.80 miliardë lekë.

Banka e Shqipërisë ka vendosur të mos rinovojë këto blerje për shkak të pritjeve për rënie të mungesës në nivele minimale në fillim të vitit 2025, si rezultat i efektit të ndërhyrjeve në tregun valutor dhe mundësisë së shpenzimeve të rritura të MF në fillim të vitit.

Vlera e portofolit të bonove të thesarit të Bankës së Shqipërisë rezulton në nivelin 66.80 miliardë lekë, pranë niveleve maksimale të vërejtura, por në terma relativë kundrejt borxhit publik të emetuar në monedhën kombëtare, madhësia e portofolit është nën 10% kundrejt rreth 25% në fillim të viteve 2000.



1.4 Përdorimi i operacioneve rregulluese

Gjatë periudhës, nuk janë zhvilluar operacione rregulluese.


2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2024

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Gjatë 3-mujorit të tretë të vitit 2024, sikurse lajmëruar edhe gjatë muajit dhjetor 2023, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar gjashtë ankande për blerjen e valutës, ku në përputhje me objektivin e zhvillimit të tregut, dy prej tyre kanë qenë me opsionin FORWARD.

Në ankandet e zhvilluara janë blerë 94.40 milionë euro kundrejt përkatësisht 101.60 milionë euro dhe 32.60 milionë euro të blera në tremujorët e mëparshëm. Mesatarja e blerë në ankandet e këtij tremujori ka rezultuar në vlerën 15.70 milionë euro, me një përmirësim krahasuar me 14.50 milionë euro në shtatë ankandet e zhvilluara në tremujorin e kaluar.

Krahas blerjeve me ankand, me anë të ndërhyrjeve në tregun valutor, në përmbushje të objektivave të politikës monetare ose të stabilitetit financiar, janë blerë 176.10 milionë euro, duke e çuar totalin e blerjeve gjatë tremujorit të tretë në 270.50 milionë euro.



Kalendari i ndërhyrjeve - Viti 2024			
	Data	Shuma Raundi I (ne euro)	
1	16/02/2024	5-10 mln	1 mo FW
2	15/03/2024	5-10 mln	
3	26/03/2024	5-10 mln	1 mo FW
4	19/04/2024	5-10 mln	
5	30/04/2024	5-10 mln	1 mo FW
6	17/05/2024	5-10 mln	
7	24/05/2024	5-10 mln	1 mo FW
8	06/06/2024	5-10 mln	
9	13/06/2024	5-10 mln	1 mo FW
10	21/06/2024	5-10 mln	
11	12/07/2024	5-10 mln	
12	19/07/2024	5-10 mln	
13	26/07/2024	5-10 mln	
14	09/08/2024	5-10 mln	
15	16/08/2024	5-10 mln	1 mo FW
16	17/09/2024	5-10 mln	1 mo FW
17	18/10/2024	5-10 mln	1 mo FW
18	20/11/2024	5-10 mln	1 mo FW
19	05/12/2024	5-10 mln	
20	20/12/2024	5-10 mln	1 mo FW

** Në rastet kur ankandi bie në ditë pushimi, ankandi do të organizohet në ditën pasardhëse të punës.*

Gjatë vitit 2024, me objektiv rritjen e rezervës valutore, Banka e Shqipërisë synon të blejë përmes ankandeve 250-330 milionë euro.

2.2 Veprime me institucione të tjera

Pas maturimit në tremujorin e dytë të të gjitha marrëveshjeve SWAP dhe likuiditetit të lartë në llogaritë e veta, Ministria e Financave nuk ka përdorur marrëveshjet SWAP me Bankën e

Shqipërisë. Në veprime të tjera, janë blerë 0.27 milionë euro nga MFE në kuadrin e fondeve të programit IPA.